

V E N D I M
Nr.238, datë 25.5.1993

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË KREDISË SË AKORDUAR NGA IDA PËR
PROJEKTIN E BANESAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kushteve të kredisë prej 15 milion dollarë akorduar nga IDA për projektin e banesave për Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- Livrimi i kredisë kryhet në kufirin kohor 1993-1997.

- Shlyerja fillon në vitin 2003 dhe do të zgjasë 40 vjet.

Pagesa do të realizohet në bazë të kushteve të IDA-s.

Komisioni për pjesën e papërdorur do të jetë 0,05 për qind dhe për pjesën e tërhequr 0,075 për qind.

2. Kredia i akordohet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesja e saj do të jetë Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

3. Kredia zbatohet nga Enti Kombëtar i Banesave.

Ky vendim hyn hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi